



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 148 , datë 6.3.2025

P Ë R

**DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.104, DATË 28.2.2019,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN  
E KRITEREVE PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT SHTETËROR  
TË MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE E TË KULTURËS SHQIPTARE  
DHE DHËNIEN E CERTIFIKATËS PËR NXËNËSIT NË DIASPORË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 49, të ligjit nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.104, datë 28.2.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë", bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 8 shtohen fjalët, me këtë përmbajtje:

"... i cili lëshon vërtetim për mësuesit, që janë pjesë e këtij regjistri."

b) Pas pikës 11 shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:

"11/1. Për nxënësit që kanë ndjekur programin e mësimin të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë lëshohet vërtetim i pjesëmarrjes nga autoritetet që organizojnë mësimin e gjuhës e të kulturës shqiptare në diasporë. Ky vërtetim prodhohet nga Qendra e Botimeve të Diasporës, sipas modelit dhe kërkesave të përcjella nga

misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**

**MINISTRI I ARSIMIT  
DHE SPORTIT**

**OGERTA MANASTIRLIU**